

# MSh diskuton me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi për zhvillimet në shëndetësi



Prishtinë, 6 prill 2017

Ne iniciativë të tij, Ministri i Shëndetësisë Imet Rahmani, priti sot në një takim informues në MSh anëtarët e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë takim, Ministri Rahmani i njoftoi ata me zhvillimet aktuale në shëndetësi, hapat e ndërmarrë për funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, plotësimin e legjislacionit aktual dhe tema të tjera me interes nga shëndetësia.

Nga MSh është kërkuar mbështetja e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit, për realizimin e hapave legjislativ që lidhen me Fondin e

Sigurimeve Shëndetësore.

Gjithashtu, në takim, janë diskutuar edhe tema të tjera lidhur me punësimin e specialistëve dhe kategorive të tjera të profesionistëve në shëndetësi; çështje që lidhen me Inspektoratin Shëndetësor dhe të tjera.